



ZHVILLIMET E TREGUT PËR OPEN BANKING SFIDAT DHE PRITSHMËRITË PËR VITIN 2025

DENIZ DERALLA

DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES


TIRANË, 5 DHJETOR 2024

KUADRI LIGJOR E RREGULLATIV PËR OPEN BANKING


- Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit “Për shërbimet e pagesave”.
- Rregullorja 29/2022 “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit” **hyri në fuqi në datën 1 janar 2024**, duke iu lënë subjekteve kohë të mjaftueshme në dispozicion për të zhvilluar ndërfaqet e tyre për *Open Banking*.
- Rregullorja parashikon kërkesa për vendosjen e **standardeve të përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit** ndërmjet palëve të përfshira në shërbimet e pagesave në kuadër të *Open Banking*.
- Rregullorja parashikon kërkesa për **mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të personalizuar të sigurisë** së përdoruesve të shërbimeve të pagesave.
- Rregullorja parashikon kërkesa për zbatimin e **Autentifikimit të Thelluar të Klientit** dhe **rastet përjashtimore**, bazuar në disa kritere.

OPEN BANKING NË DALLIM NGA BANKING TRADICIONAL

Traditional Banking



Open Banking



ZHVILLIMET GJATË VITIT 2024 PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING - BSH

- Gjatë vitit 2024, Banka e Shqipërisë ngriti një grup teknik pune me pjesëmarrjen e ekspertëve nga disa departamente, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullores 29/2022.
- Grupi i punës ka organizuar një sërë takimesh me bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, ku janë diskutuar çështje teknike të ngritura nga subjektet dhe janë sqaruar teknikalitetet e funksionimit të bankingut të hapur.
- Grupi i punës ka kërkuar vazhdimisht informacion të përditësuar nga subjektet, mbi statusin e përgatitjes për implementimin e bankingut të hapur, nga bankat dhe ofruesit e palëve të treta (TPP).
- Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me autoritetet vendase (AKSHI dhe AKSK), për të siguruar funksionimin e plotë të ndërfaqeve sipas standardeve Evropiane.
- Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me SHSHB, hartuan një dokument që përcakton elementët e standardizuar dhe specifikimet teknike që duhet të përmbajnë certifikatat e kualifikuara elektronike që do të lëshojë AKSHI për qëllime të *Open Banking*.

ZHVILLIMET GJATË VITIT 2024 PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING - BANKAT

- Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të rregullores 29/2022, aktorët e tregut morën masa për të bërë funksional bankingun e hapur në praktikë.
- Bankat janë angazhuar për sigurimin e plotësueshmërisë së kërkesave të rregullores dhe për të operacionalizuar bankingun e hapur.
- Meqënëse funksionimi i bankingut të hapur kërkon elementë shtesë sigurie dhe ndërveprimi me aplikacione dhe ndërfaqe të palëve të treta, bankat janë angazhuar dhe kanë investuar në drejtim të përmirësimit e përshtatjes së sistemeve të tyre informatike.
- Bankat kanë përzgjedhur ofruesit e përshtatshëm për të mundësuar *Open Banking* dhe kanë siguruar API (*Application Programming Interfaces*) përkatëse nëpërmjet ofruesve të këtyre ndërfaqeve.
- Bankat kanë publikuar *Sandbox*-et përkatëse dhe kanë kryer testimet e ndërfaqeve dhe të komunikimit të sigurt me disa ofrues të shërbimeve të pagesave (TPP).
- Pas specifikimeve teknike nga Banka e Shqipërisë sipas kërkesave të rregullores 29/2022, bankat janë pajisur me certifikatat e kualifikuara elektronike test nga AKSHI, për të testuar funksionimin e bankingut të hapur.

STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË OPEN BANKING NGA BANKAT

- Sipas komunikimeve në fund të nëntorit dhe fillim të muajit dhjetor 2024, rezulton që bankat janë gati teknikisht për të dalë *live* në ofrimin e shërbimeve të Open Banking.
- Me marrjen e certifikatës së kualifikuar elektronike finale (*Production*) nga AKSHI, si për bankat ashtu edhe për TPP që kanë marrë miratimin përkatës nga BSH, do të mundësohet implementimi i plotë i *Open Banking*.


ZHVILLIMET GJATË VITIT 2024 PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING - TPP

- Meqënëse funksionimi i bankingut të hapur kërkon elementë shtesë sigurie dhe ndërveprimi me ndërfaqet e bankave, ofruesit e palëve të treta (TPP) të interesuar kanë krijuar dhe përshtatur infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të pagesave 7 dhe 8.
- 5 TPP kanë aplikuar në Bankën e Shqipërisë për marrjen e miratimit për ushtrimin e veprimtarisë së bankingut të hapur, ku 1 prej tyre ka marrë miratimin në nëntor 2024.
- TPP e interesuara janë pajisur me certifikatat e kualifikuara elektronike test nga AKSHI, për të testuar funksionimin e bankingut të hapur.
- TPP kanë realizuar integrimet dhe testimet përkatëse ose janë në faza testimi të ndërfaqeve dhe të komunikimit të sigurt me bankat.
- Pas miratimit nga BSH, TPP duhet të pajisen me certifikatat finale (*Production*) për të operuar *live* me bankat.

STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË OPEN BANKING NGA TPP

Sipas komunikimeve me institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike (TPP) në fund të nëntorit dhe fillim të muajit dhjetor 2024, statusi dhe planifikimet për implementimin e plotë të Open Banking paraqiten si vijon.

Statusi i TPP për funksionimin e *Open Banking*



- TPP që kanë marrë miratim për Open Banking
- TPP që kanë aplikuar për të marrë miratim për Open Banking
- TPP që planifikojnë të aplikojnë për të marrë miratim për Open Banking

SFIDAT PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING NË 2025

- Institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike që operojnë në treg, **inkurajohen të konsiderojnë ofrimin e shërbimit të inicimit të pagesës dhe të informimit të llogarisë.**
- Bankat dhe TPP e licencuara, duhet të pajisen me **certifikatat e kualifikuara elektronike finale (Production)** për të mundësuar funksionimin e *Open Banking*.
- Banka e Shqipërisë do vijojë komunikimet me AKSHI mbi **mundësinë e lëshimit edhe të certifikatave Qwac** dhe jo vetëm *Qseal* për subjektet e licencuara prej saj.
- Bankat dhe TPP duhet t'i **kushtojnë rëndësi sigurisë së ofrimit të shërbimeve** për klientët, si dhe **administrimit të rreziqeve.**
- Subjektet e përfshira në ofrimin e shërbimeve të *Open Banking* duhet të ndërmarrin hapa konkretë për **njoftimin e klientëve** të tyre për ofrimin e këtyre shërbimeve, si dhe për **përfitimet që vijnë prej tyre.**



JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!